

KËRCËNIMET MJEDISORE NGA MBETURINAT URBANE TË NGURTA NË ZONËN E KORÇËS

(SOLID URBAN WASTE POLLUTION IN KORÇA)

Robert DAMO, Pirro IÇKA

Departamenti i Agronomisë, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë,
SHQIPËRI

E-mail: *r.damo@hotmail.com*

PËRMBLEDHJE

Sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave urbane të ngurta në rajonin e Korçës konsiston kryesisht në grumbullimin dhe depozitimin e mbeturinave në vend depozitim dhe nuk mund të flitet për teknologji përpunimi. Një situatë e tillë, e shoqëruar me djegien e mbeturinave, depozitimin e përbashkët me mbetjet e rrezikshme spitalore, të industrisë etj., shkakton një sërë problemesh mjedisore si ndotja e ujit nëntokësor të pellgut ujëmbajtës të Korçës, e ujërave të Liqenit të Ohrit, ndotjen e ajrit etj. Ndryshimi i teknologjisë së menaxhimit të mbeturinave, shoqëruar me riciklimin e tyre do të përmirësonte ndjeshëm mjedisin e rajonit.

Fjalët kyçe: mbeturina të ngurta urbane, djegie e mbeturinave, ndotje ajri, mbetje të rrezikshme.

ABSTRACT

The actual management of the urban solid wastes in Korça region consists on the accumulation and storage at land field without any treatment technology. In this situation when: the urban wastes are burned, hazardous hospital and industrial wastes are stored to the same land field, etc, represents a serious threatening for the pollution of the first underground layer of water catchment

for Korça and Lake Ohrid water. The change to the management technology of the solid wastes, followed by recycling process will improve thoroughly the environmental conditions of Korça region.

Key words: urban solid wastes, burn of wastes, air pollution, hazardous wastes, sanitary field.

1. HYRJE

Sheshet e depozitimit të mbeturinave të ngurta urbane në rajonin e Korçës përbëjnë një rrezik të madh për shëndetin e popullsisë dhe për mjedisin. Për ndryshimin e situatës, qysh në pranverën e vitit 2003, në këtë rajon ka filluar puna për projektin e Menaxhimit të mbeturinave të ngurta për Shqipërinë Juglindore [1]. Zona e projektit është identike me Qarkun e Korçës, me një sipërfaqe prej 4210 km² të ndarë në katër rrethe: Korçë, Pogradec, Devoll dhe Kolonjë [2], me popullsi rreth 265.000 banorë (INSTAT, 2004). Analizat demografike tregojnë se popullsia e rajonit për 20 vitet e ardhshme pak a shumë do të jetë në shifrat e sotme [1].

Realizimi i këtij projekti do të çojë në përmirësimin e kushteve mjedisore dhe ekonomike të zonës, nëpërmjet konceptit të menaxhimit të integruar të mbeturinave dhe ndërtimit të një

fushe sanitare mbetjesh. Megjithëse kanë kaluar disa vite, ende projekti nuk është realizuar dhe problemet po thellohen. Evidentimi i tyre mund të kontribuojë në përmirësimin e situatës dhe zgjidhjen afatgjatë e të qëndrueshme të tyre.


2. GJENDJA DHE TRAJTIMI I MBETURINAVE NË RAJONIN E KORÇËS

Situata e mbetjeve urbane në bashkitë dhe komunat e rajonit vlerësohet e vështirë. Praktika aktuale e menaxhimit të mbeturinave konsiston kryesisht në grumbullimin, transportin dhe depozitimin e tyre. Nuk mund të flitet për menaxhim mbeturinash pothuajse në gjithë komunat, ku mbeturinat hidhen në shumë vende, kryesisht anës përrrenjve. Në disa komuna si në Dvoran, Voskopojë, Buçimas etj. punohet mirë për grumbullimin e mbeturinave, por përpunimi i tyre si edhe në bashkitë pothuajse mungon tërësisht. Grumbullimi i mbetjeve në qytetet vlerësohet në masën mbi 90% kurse për gjithë qarkun 40-60% [2].


Prodhimi i mbeturinave urbane për qytetin e Korçës është rreth 350 kg/banor/vit, prej së cilës rreth 310 kg shkojnë në fushën e depozitimit, në komuna vlerësohet me 165 kg/b/v [1].

Mbetjet organike zënë 37% të peshës së përgjithshme të mbeturinave, nga e cila 20-25% janë mbeturina të kuzhinës, pjesa tjetër të kopshteve; plastike 11%, letër-karton 11%, metale dhe qelqë respektivisht me 2% të peshës (Graf. 1). Mbeturinat e riciklueshme përfshijnë 26% të mbeturinave urbanë (pa llogaritur mbeturinat organike). Mbeturinat urbane për zonën e projektit vlerësohen me rreth 150 ton/ditë ose rreth 60.000 t/vit [1].

Grafiku 1. Përbërja e mbeturinave shtëpijake në qytetin e Korçës



Sipas të dhënave të projektit të SIDA-s (2006), përbërja e mbetjeve për bashkinë e Korçës dhe të



Pogradecit jepet në grafikun 2.

Mbetjet e rrezikshme vlerësohen rreth 80 ton në vit në bashkinë e Korçës, rreth 40 ton për Pogradecin dhe më pak në bashkitë dhe komunat e tjera, në total rreth 200 ton/vit. Mbeturinat e industrisë vlerësohen rreth 4000 ton në vit për Korçën, ndërsa sasia në bashkitë e tjera dhe komunat është e vogël. Mbeturinat mjekësore të ndotura në zonën e projektit vlerësohen rreth 60 tonë në vit dhe mbeturinat e ndërtimit më shumë se 4500 ton në vit [1].

Kostoja e grumbullimit të mbeturinave shkon nga rreth 8 €/ton në bashkinë e Pogradecit në 25 €/ton në atë të Maliqit [1, 2], çka tregon se ai është i shtrenjtë dhe jo efektiv, sidomos në bashkitë e vogla. Tarifa për mbeturinat në qytetin e Korçës është 900 lekë/familje/vit, në Pogradec 240 lekë/banor/vit, Bilisht dhe Ersekë 600 lekë/familje/vit. Në përgjithësi komunat nuk kanë vendosur tarifë pastrimi, por ka komuna si ajo e Dvoranit që tarifa është mbi nivelin e bashkive. Grumbullimi i tarifave nga familjarët është i ulët (40-60%). Të ardhurat e bazuara në tarifat ekzistuese të familjarëve dhe bizneseve mbulojnë rreth 60% të kostos aktuale të pastrimit për qytetin e Korçës dhe Bilishtit, rreth 75% për Ersekën.

Aktivitetet për reduktimin e mbeturinave janë spontane. Banorët, kryesisht romë, grumbullojnë

metalet nga kazanët në rrugë dhe në fushat e grumbullimit të mbeturinave.

2.1. KËRCËNIMET MJEDISORE NGA MBETJET

Praktikat ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave përbëjnë rrezik serioz për shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin. Rreziku është rrjedhojë e depozitimit të mbeturinave në fusha të ndërtuara në vende të papërshtatshme, të pa mbrojtura, të pasigurta, shumë afër zonave të banuara, kohës së gjatë të shfrytëzimit të tyre, djegies së mbeturinave etj.

2.1.1. VENDNDODHJA E FUSHAVE EKZISTUESE

Për depozitim të mbeturinave në Korçë janë shfrytëzuar gropat e marrjes së argjilës prej fabrikës së tullave. Sheshi ndodhet mbi basenin e ujit nëntokësor të Korçës, afër të ashtuquajturës "Fusha e Puseve të Turanit", rreth 2 km larg stacionit të pompave dhe jo më larg se 1,2 km nga burimi më i afërt i kësaj fushe. Zona e banuar më e afërt është rreth 100 m, ndërsa periferia e qytetit rreth 500 m [5]. Mungojnë tërësisht standardet e sigurisë: izolimi, drenazhimi, mbledhja dhe përpunimi i kullimeve, mbulimi i mbeturinave, rrethimi. Heqja e shtresës argjilore, që shërben si izolues dhe mbrojtëse e ujërave nëntokësore, e bën më problematike ekzistencën e kësaj fushe në këtë vend.

Sheshi i plehrave në Pogradec ndodhet afërsisht 4,5 km nga bregu i Liqenit të Ohrit, mbi një zonë karstike që komunikon me liqenin dhe bu-

Tabela 1. Treguesit e cilësisë së ajrit gjatë djegies së mbeturinave në vend-depozitim të Bilishtit

$\mu\text{g m}^{-3}$	PM ₁₀	CO	SO ₂	NO ₂	Pb
21-22 korrik	800	2500	200	320	0,6
22-23 korrik	1200	4000	260	480	0,7
23-24 korrik	540	2000	180	200	0,5
Mesatarja	847	2833	213	300	0,6
Norma lejuar Shqipëri	60	2000	60	60	1
Norma lejuar EU	50	2000	50	40	0,5

Burimi: Projekti i SIDAS-s, 2006

Tabela 2. Përbërja e mbeturinave në Korçë dhe Pogradec

Viti	Ndotësit, $\mu\text{g}/\text{m}^3$				
	LGS P. total	PM ₁₀ P. respiruesh.	SO ₂	NO ₂	Pb
2002	155	70	14	21	0,16
2003	147	67	8	12	0,066
2004	137	56	8	11	0,21
2005	140	63	10	12	0,12
2006	172	82	10	14	0,18
Mes. 5 vjeçare	150,2	67,6	10	14	0,147
Norma jonë	140	60	60	60	1,0
Norma BE	90	50	50	40	0,5

Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik Korçë

rimet ujore në afërsi të tij. Edhe në Ersekë fusha është vendosur mbi një zonë karstike, rreth 1,2 km larg qytetit; në Bilisht është vendosur direkt në bregun e lumit Devoll, ndërsa në Maliq ndodhet shumë afër brigjeve të tij [5].

Ekzistojnë shumë vende grumbullimi mbeturinash të vogla, në komuna por edhe në qytete. Pjesa më e madhe e mbeturinave nëpër fshatra hidhen anës përrrenjve, rrugëve dhe kanaleve.

2.1.2. NDOTJA E AJRIT DHE UJIT

Djergia e plehrave si dukuri e zakonshme në të gjitha vend-depozitimet ndikon mbi cilësinë e ajrit (Tab. 1). Në mjedisin afër djegies me përjashtim të plumbit, treguesit e tjerë të cilësisë së ajrit janë shumë mbi normën e lejuar: PM₁₀ deri 12 herë më shumë, SO₂ dhe NO₂ 3-5 herë më shumë. Djergia e plehrave është burimi kryesor i ndotjes së ajrit në fushëgropën e Korçës (Tab. 2), ndërsa në zonën e Pogradecit djergia e plehrave i shtohet ndotësit më të madh të ajrit, që është trafiku [1].

Vendndodhja e fushave të plehrave mbi zonat ujëmbajtëse ose karstike, në brigjet e lumenjve ose përrrenjve rrezikon ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Kullimet e fushës së plehrave në Korçë rrezikojnë të ndotin shtresën e parë të ujit nëntokësor të zonës së Puseve të Turanit. Depozitimi i mbeturinave brenda zonës karstike dhe kullimet ndikojnë mbi burimet e Liqenit të Ohrit brenda 24 orëve [5]. Zonat ujore karstike afër bregut të liqenit përdoren si burim kryesor për ujë të pijshëm për qytetin dhe fshatrat përreth.

Sheshi i grumbullimit në Bilisht i vendosur direkt në bregun e lumit Devoll, bën që kullimet dhe mbetjet e tjera të rrëshqasin direkt në lumë. Në rast fryrje të lumit ka ndotje masive. Lumi i Devollit është i kërcënuar edhe nga kullimet e sheshit të plehrave në Maliq, për shkak të afërsisë shumë të madhe me brigjet e lumit dhe mungesës së trajtimeve. Hedhja e mbeturinave nga komunat anës përrrenjve, të cilat për rrethin e Korçës dhe Devollit bëjnë pjesë kryesisht në pellgun ujëmbledhës të Devollit rrisin mundësinë e ndotjes të lumit dhe të burimeve ujore të tjera.

2.1.3. NDOTJA NGA MBETJET E RREZIKSHME

Mbetjet e papërpunuara të spitaleve depozito-

hen së bashku me mbeturinat e tjera pa përpunim paraprak dhe të mëtejshëm. Shkalla e ndikimit të tyre me mikroorganizma patogjene dhe kimikate është e lartë. Hedhja e paligjshme në fushën e plehrave e helmeve dhe mbetjeve të tjera të rrezikshme industriale dhe shtëpiake kërcënojnë shëndetin e rrëmuesve dhe të banorëve në afërsi të tyre. Përdorimi i zjarrit në fushat ekzistuese të mbeturinave rrit rreziqet për shëndetin nga mbetjet spitalore.

2.1.4. KËRCËNIME TË TJERA

Mjedisi tejet i rënduar në vend-depozitimet e mbeturinave favorizon rritjen dhe zhvillimin e insekteve sëmundje shkaktuese. Mbjatja e kafshëve në fushën e Korçës dhe të Maliqit, përbën rrezik serioz për popullsinë që konsumon mishin e tyre. Kërcënim të mundshëm për shëndetin e njerëzve përbëjnë edhe prodhimet e ndryshme bujqësore të kultivuara pranë vend-depozitimeve të plehrave.

3. MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETURINAVE ZGJIDHJE MJEDISORE

Për përmirësimin e kushteve mjedisore në zonën e Korçës po zbatohet projekti për menaxhimin e mbeturinave të ngurta urbane për Shqipërinë juglindore me kosto investimi, për një periudhë 20 vjeçare, prej 16,5 milionë € dhe kosto operimi dhe mirëmbajtjeje 15,5 milionë € [1, 4]. Zbatimi i tij synon reduktimin e rreziqeve mjedisore, operimin efektiv dhe mjedisor të aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave, krijimin e një fushe sanitare, zbatimin e konceptit për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe krijimin e një strukture të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave. Sistemi i menaxhimit të mbeturinave do të kryhet nga Kompania Rajonale e Menaxhimit të Mbetjeve (KRMM Sh.A). Themelimi i saj është shembulli i parë i krijimit të një subjekti me kompetenca të përbashkëta midis njësive të ndryshme të qeverisjes vendore për vendin tonë.

Fusha e re sanitare e depozitimit të mbeturinave është njësia bazë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave. Vendi i miratuar ndodhet 1,2 km në veri-perëndim të qytetit të Maliqit dhe 2 km larg rrugës nacionale, me sipërfaqe të përgjithshme

të aprovuar prej 22 ha dhe të kërkuar prej 19 ha [6]. Si rezultat i sistemit të riciklimit dhe sidomos kompostimit të mbeturinave organike nëpër fshatra (në oborret prapa shtëpive), të propozuar nga SIDA, sipërfaqja e shfrytëzuar planifikohet të jetë 13,1 ha [4]. Mendojmë se kompostimi mund të dështojë, prandaj mund të nevojitet e gjithë sipërfaqja e kërkuar. Sasia ditore e mbeturinave të depozituara në fushën e re llogaritet 150-160 t/ditë ose rreth 60.000 ton në vit, jetëgjatësia e fushës 20 vjet dhe kapaciteti rreth 1,5 milionë m³ [1, 4]. Teknologjia e parashikuar në fushën e depozitimit siguron standarde të lartë të mbrojtjes së ujit nëntokësor dhe të lumit si dhe mbrojtjes së ajrit.

Prodhimi i kullimeve llogaritet 20-45 m³/ditë, ose rreth 15.000 m³ në vit [1]. Për trajtimin e tyre parashikohet 3 ha tokë. Masat teknike për mbrojtjen e ujërave nëntokësore përmes izolimit të kullimeve dhe përpunimit të tyre janë një zhvillim i ri për rajonin e Korçës edhe për vendin tonë.

Instalimi i rreth 26 stacioneve për mbledhjen e mbetjeve të rrezikshme, trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore me djegie (furra mund të vendoset në fushën e depozitimit dhe t'i shërbejë gjithë rajonit) do të çojë drejt minimizimit të kërcënimeve për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin [4].

Sistemi i riciklimit do të përbëhet nga grumbullimi i mbeturinave të riciklueshme direkt nga familjarët. Ndarja e tyre do të bëhet me dorë në vende të përshtatshme. Mendojmë se depozitimi i fraksionuar i materialeve të riciklueshme, pavarësisht koston së lartë prej 32,6 €/t ndaj 15,3 €/ton [4] të grumbullimit me qese në familje, do të jetë zgjidhja më e mirë. Dështimi, ashtu si e kishim parashikuar dhe sugjeruar ekspertëve të huaj, i operimit për riciklimin e mbeturinave nga Shoqata për pastrim, në kuadrin e një projekti pilot të SIDA-s në Korçë e përforcon mendimin tonë.

Llogaritet që tarifat shtëpiake me Tvsh të jenë 3,38 €/muaj për familje ose 5000 lekë/vit/familje [4], aktualisht të papërbalueshme për shumicën e banorëve të zonës. Ky fakt mund të ndikojë negativisht në zbatimin e plotë të projektit dhe në rentabilitetin e KRMM SH.A.

PËRFUNDIME

Trajtimi aktual i mbeturinave përbën një kërcënim serioz për shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit dhe një barrierë për zhvillimin e zonës.

Sistemi i integruar i menaxhimit të mbeturinave nuk mund të jetë i qëndrueshëm dhe efektiv pa siguruar mbulimin e kostos së menaxhimit të mbeturinave nëpërmjet rritjes graduale të tarifave dhe sidomos grumbullimit tërësor të tyre.

Ndërgjegjësimi i publikut, i mangët aktualisht, duhet të ecë paralelisht me ndryshimin e teknologjisë së menaxhimit të mbeturinave të ngurta urbane.

Përmirësimi i situatës kërkon zbatimin rigoroz të ligjit dhe ndëshkimin e gjithë subjekteve që shkelin rregullat e administrimit të mbetjeve të ngurta.

Rehabilitimi i shpejtë i fushave ekzistuese është i domosdoshëm për të minimizuar kërcënimet mjedisore.

Projektet e pjeshme pilot janë pak efektive dhe në shumicën e rasteve të dështuara, prandaj për përmirësimin e gjendjes kërkohet përshejtimi i implementimit të plotë të projektit, zgjatja e tepruar e të cilit përkeqëson situatën.

BIBLIOGRAFIA

1. Abstrakti i Fizibilitetit Final, *Studimi i Menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore* (2005).
2. Fushat ekzistuese të plehrave, rreziqet mjedisore dhe konceptet e rehabilitimit të tyre, *Studimi i Fizibilitetit Menaxhimi i mbeturinave të ngurta për Shqipërinë Juglindore*, 2003.
3. BONI M.R. (2007) *Fenomeni di inquinamento degli ambienti naturali. Principi e metodi di studio*, Editore Carocci, Roma.
4. GOPA (2008) *Projekti për menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Rajonin e Korçës (faza lidhëse)*.
5. *Studimi i ndikimit mjedisor për Menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore*. Fusha e depozitimit Maliq, Veri, 2004.

